



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr. 02/L-2

**PËR STATUSIN DHE TË DREJTAT E FAMILJEVE TË DËSHMORËVE,
INVALIDËVE, VETERANËVE DHE PjesËtarËve TË UÇK-së DHE FAMILJEVE
TË VIKTIMAVE CIVILE TË LUFTËS**

Kuvendi i Kosovës,

Duke u bazuar në Kreun 9.1.26(a) dhe 5.1 (g), të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja nr. 2001/9 të datës 15 maj 2001) ;

Duke pasur parasysh Rezolutën e Kuvendit të Kosovës të nxjerrë më datën 15 maj 2003, për Luftën Çlirimtare të Popullit të Kosovës për Liri dhe Pavarësi;

Me qëllim të rregullimit të statusit të familjes së dëshmorit, invalidit, veteranit, pjesëtarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe anëtarëve të familjeve të tyre si dhe kategorive të tjera, të përcaktuara me këtë Ligj

Me qëllim të përcaktimit të të drejtave dhe të sigurimit të mbrojtjes së posaçme, të familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve, invalidëve të vdekur, pjesëtarëve të marrë peng ose të zhdukur të UÇK-së, si dhe anëtarëve të familjeve të tyre,

Me qëllim të sigurimit të një kornize ligjore për njohjen dhe respektimin e statusit dhe të të drejtave të bartësve të luftës së fundit në Kosovë:

Miraton:

LIGJIN

**PËR STATUSIN DHE TË DREJTAT E FAMILJEVE TË DËSHMORËVE,
INVALIDËVE, VETERANËVE DHE PjesËtarËve TË UÇK-së DHE FAMILJEVE
TË VIKTIMAVE CIVILE TË LUFTËS**

KREU I

DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Fushëveprimi

Më këtë Ligj, rregullohet dhe përcaktohet:

1.1. Statusi i dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (në tekstin e mëtejme UÇK) dhe anëtarëve të familjeve të tyre, të drejtat dhe beneficionet e posaçme për anëtarët e familjeve të dëshmorëve, invalidët, veteranët,

invalidët e vdekur, pjesëtarëve të marrë peng ose të zhdukur të UÇK-së dhe anëtarëve të familjeve të tyre, si dhe kushtet dhe procedurat për realizimin e këtyre të drejtave.

1.2. Statusi dhe të drejtat e viktimave civile, invalidëve civil të luftës dhe familjeve të të marrurve peng dhe të zhdukurve të luftës.

Neni 2 Përkufizimet

Termat dhe shkurtesat e përdorura në këtë Ligj, kanë këtë kuptim dhe domethënie:

(1) Dëshmor i Kombit është pjesëtari i UÇK-së që:

1. Ka rënë në luftë kundër okupatorit nga 30 dhjetor 1991 deri më 19 shtator 1999.
2. Është plagosur nga forcat e armikut dhe ka vdekur brenda 1 viti nga dita e plagosjes më së voni 1 vit pas datës 19 shtator 1999.
3. Ka vdekur nga sëmundja si pasojë e Luftës për Çlirimin e Kosovës më së voni 1 vit pas 19 shtator 1999.
4. Si shtetas i huaj është vrarë si pjesëtar i UÇK-së, për lirinë e Kosovës.

(2) Dëshmor i Kombit është atdhetari që ka vepruar për çështjen kombëtare individualisht ose i organizuar në grup, i cili është vrarë në forma të ndryshme apo ka rënë në luftë kundër okupatorit në të gjitha periudhat e luftës për liri.

(3) Invalid i UÇK-së është luftëtari i UÇK-së, organizmi i të cilit është dëmtuar së paku 10%, për shkak të plagës apo sëmundjes që ka pësuar në luftë për çlirimin e Kosovës, apo si i internuar (i burgosur) në burgjet apo kampet e armikut; si dhe shtetasi i huaj si veteran i UÇK-së.

(4) Invalid civil i luftës është personi, organizmi i të cilit është dëmtuar së paku 40 % si pasojë e plagës apo lëndimit të shkaktuar gjatë luftës në Kosovë prej 27.02.1998 deri më 20.06.1999, si dhe personat e tjerë organizmi i të cilëve është dëmtuar mbi 40% si pasojë e mjetëve shpërthyesë të mbetura pas përfundimit të luftës.

(5) Veteran dhe pjesëtar i UÇK-së, është qytetari i Kosovës dhe shtetasi i huaj i cili është radhitur në radhët e UÇK-së dhe është regjistruar si ushtar nga komandat (shtabet e zonave operative të UÇK-së, përkatësisht Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, brenda periudhës 30.12.1991 deri më 20.06.1999.

(6) Viktimë civile e luftës, konsiderohet personi i cili ka vdekur nga pasojat e luftës në Kosovë, prej 27.02.1998 deri më 20.06.1999, si dhe personat të cilët konsiderohen të zhdukur gjatë kësaj periudhe kohore, si dhe personat që kanë pësuar nga mjetet shpërthyesë që kanë mbetur nga pasojat e luftës.

(7) Peng i luftës konsiderohet veterani dhe pjesëtari i UÇK-së i cili gjatë luftës çlirimtare të Kosovës është arrestuar dhe internuar në kampet e armikut së paku 3 ditë (72 orë).

(8) Peng civil i luftës konsiderohet personi civil, i cili gjatë luftës është arrestuar dhe internuar në kampet e armikut së paku 3 ditë (72 orë).

(9) Ushtar i zhdukur (i pagjetur) i UÇK-së, është veterani dhe pjesëtari i UÇK-së, fati i të cilit ende nuk është zbardhur.

(10) Person civil i zhdukur (i pagjetur), konsiderohet personi civil, i cili është zhdukur në periudhën e luftës, fati i të cilit ende nuk është zbardhur.

(11) Anëtarë të familjes së ngushtë në kuptim të këtij Ligji janë: bashkëshorti, bashkëshortja, fëmijët, fëmijët jashtëmartesor, fëmijët e adoptuar (birësuar), thjeshtri, thjeshtra, prindërit, njerku, njerka, si dhe bashkëshorti/ bashkëshortja jashtëmartesore. Statusi i bashkësisë jashtëmartesore sipas këtij Ligji përcaktohet me procedurë gjyqësore jashtëkontestimore.

(12) Përparësitë në realizimin e të drejtave, sipas këtij Ligji, në mes të anëtarëve të familjes, përcaktohen sipas dispozitave të trashëgimisë. Anëtarët e familjes të radhës së njëjtë të trashëgimisë, i realizojnë të drejtat sipas marrëveshjes së ndërsjellë. Në qoftë se marrëveshja nuk arrihet, përparësi në realizimin e të drejtës ka anëtari i familjes nga radha e njëjtë e trashëgimisë i cili me personin nga i cili realizohet e drejta ka jetuar në bashkësi të njëjtë familjare.

(13) Njerku dhe njerka i realizojnë të drejtat sipas këtij Ligji, nëse personi nga i cili realizohet e drejta e kanë mbajtur, ose atë person e kanë mbajtur më së paku pesë vjet para vdekjes së tij.

(14) Thjeshtri/a është personi i cili nuk e ka të gjallë njërin prind, apo prindit i është marrë e drejta me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës, ndërsa personi nga i cili realizohet e drejta e ka mbajtur më së paku një vit para vdekjes së viktimës, të zënies rob apo të zhdukjes.

KREU II TË DREJTAT E PËRCAKTUARA ME KËTË LIGJ

Neni 3

E drejta në pension dhe benificione të ndryshme

Të drejtat në pension dhe benificione të ndryshme, përfituesve do t'iu ofrojnë mbështetje financiare dhe benificione të veçanta, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë Ligj.

Neni 4

Format e pensioneve

Pensionet e përcaktuara në këtë Ligj janë:

1. Pensioni familjar të cilin e realizon familja e dëshmorit dhe familja e viktimës civile, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë Ligj.
2. Pensioni invalidor personal të cilin e realizon invalidi i UÇK-së dhe invalid civil i luftës, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë Ligj.
3. Pensioni invalidor familjar të cilin e realizon familja pas vdekjes së invalidit, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë Ligj.

Neni 5 Benificionet e veçanta

5.1. Kategoritë e përfshira në këtë Ligj të cilët janë objekt shqyrtimi dhe rregullimi varësisht nga statusi dhe kriteret e përcaktuara, janë edhe përfitues të benificioneve të ndryshme.

5.2. Benificionet e ndryshme për përfituesit e të drejtave të përcaktuara me këtë Ligj janë:

1. Shtesa për përkujdesje dhe ndihmë nga personi tjetër është e drejtë të cilën e realizon invalidi i UÇK me shkallë të invaliditetit mbi 80%.

2. Rehabilitimi mjekësor apo fizikal është e drejtë që e realizojnë të gjithë invalidët e UÇK-së, më prioritet sipas shkallës së invaliditetit.

3. Shërbimet shëndetësore primare janë të drejta të cilat i realizojnë pa kompensim në institucionet shëndetësore publike, të gjitha familjet e dëshmorëve, invalidët e UÇK-së, veteranët dhe pjesëtarët e UÇK-së.

4. Shërbimet shëndetësore sekondare dhe terciare janë të drejta të cilat i realizojnë pa kompensim, familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës.

5. Shërbimet shëndetësore jashtë vendit, janë të drejta të cilat i realizojnë pa kompensim, të gjithë invalidët e UÇK-së, në qoftë se është në pyetje sëmundja e cila nuk mund të shërohet në vendin tonë. Këtë të drejtë e gëzojnë edhe invalidët civil të luftës për gjendjen shëndetësore që është pasojë e luftës dhe për të cilën nuk ka shërim në vendin tone.

6. Riaftësimi profesional është e drejtë të cilën e realizon invalidi i UÇK-së, dhe invalidi civil i luftës i cili është pjesërisht i aftë për punë, duke përfshirë edhe aftësimin për kryerjen e punëve për të cilat kërkohet përgatitje profesionale më e madhe se ajo të cilën e ka pasur, pa marrë parasysh se a i sigurohet punësim pas riaftësimit profesional.

7. Kompensimi ortopedik është e drejtë në mjetet ortopedike për invalidët e UÇK-së dhe invalidët civil të luftës të cilëve u është dëmtuar organizmi nga plagosja apo sëmundja e shkaktuar nga amputimi i ekstremiteteve, por edhe ata që kanë pësuar dëmtim të rëndë të ekstremiteteve apo humbjes së tërësishme të të pamurit.

8. Përparësia në punësim në organet e Shërbimit Civil të Kosovës të nivelit qendror dhe lokal, në kushte të njëjta është e drejtë të cilën e realizojnë kategoritë e përcaktuara sipas këtij Ligji.

9. Lehtësimet tatimore dhe doganore janë të drejta të cilat i realizojnë:

1. Bashkëshorti/ja ose prindërit kur dëshmorit ka qenë i pamartuar dhe invalidët e UÇK-së prej grupit II deri në grupin e VII me rastin e importimit të automobilit njëherë në pesë (5) vjet. Në qoftë se shfrytëzuesi i të drejtës nga nënpika 1 e shet automjetin, ia dhuron dikujt ose e tjetëron në tërësi, në afat prej dy vjetësh që nga dita e blerjes, është i detyruar që të bëjë pagesën e doganës dhe tatimin nga i cili tatim ka qenë i liruar me rastin e importit.

2. Invalidët e luftës së UÇK-së me shkallë të invaliditetit 100%, me rastin e importimit të automobilit personal njëherë në dhjetë (10) vjet të cilat ia dhuron Qeveria e Kosovës.

3. Familja e dëshmorit, invalidët e luftës dhe veteranët e UÇK-së me rastin e importimit të pajisjeve teknike për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike apo profesionale të

pavarur në ekonomitë familjare. Kjo e drejtë mund të realizohet vetëm një (1) herë dhe nuk mund të tjetërsohet te personat e tretë.

10. Tarifa e lirë dhe e reduktuar e konsumit të energjisë elektrike është e drejtë të cilën e realizojnë familjet e dëshmorëve, invalidët e UÇK-së dhe familjet e viktimave civile të luftës.

11. Lirimi nga tatimi në pronë është e drejtë që e realizojnë familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës, veteranët e UÇK-së dhe familjet e viktimave civile, që janë në gjendje të rëndë materiale.

12. Stazhi i dyfishtë është e drejtë të cilën e realizojnë veteranët e UÇK-së, si të papunësuar apo të punësuar, për kohën e kaluar në luftë.

13. Përkujdesja për banim është e drejtë të cilën e realizojnë familjet e dëshmorëve dhe invalidët e UÇK-së, për të cilët Qeveria e Kosovës do të sigurojë strehim familjar përmes ndërtimit të objekteve kolektive të banimit. Prioritet për realizimin e kësaj të drejte do të kenë familjet e dëshmorëve dhe invalidët e UÇK-së, të cilët nuk e kanë të zgjidhur strehimin familjar.

14. Përparësia e regjistrimit në institucione arsimore është e drejtë të cilën e realizojnë personat që janë anëtarë të familjeve të dëshmorëve të rënë të UÇK-së, invalidët, veteranët dhe pjesëtarët e UÇK-së, anëtarët e familjeve të veteranëve të UÇK-së dhe invalidët civilë, me kusht që të kalojnë prapun e poenëve në provimet pranuese.

15. Shpenzimet e varrimit, të transportit dhe nderimet ushtarake, janë ato shpenzime dhe akte ceremoniale mortore të cilat i kompenson MPMS-ja, pas vdekjes së luftëtarit të UÇK-së apo pas procedurave të ekshumacionit dhe identifikimit të ushtarit të zhdukur të UÇK-së.

KREU III REALIZIMI I TË DREJTAVE

Neni 6

Të drejtat e familjeve të dëshmorëve të UÇK-së

6.1. Anëtarët e familjes së dëshmorit të UÇK-së sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në këtë Ligj, realizojnë këto të drejta:

1. Pensionin familjar,
2. Përparësi në punësim në kushte të barabarta,
3. Lehtësime tatimore dhe doganore,
4. Përparësi regjistrimi në institucione arsimore,
5. Bursa për shkollim,
6. Vendosje në konvikte pa kompensim,
7. Tekste shkollore falas për arsimin fillor dhe të mesëm,
8. Përkujdesjen e banimit,
9. Tarifë të lirë dhe të reduktuar të konsumit të energjisë elektrike,
10. Lirimin nga pagesa e taksave gjyqësore, administrative dhe publike,
11. Lirimin nga tatimi në pronën e paluajtshme,
12. Përkujdesje shëndetësore falas në institucione publike,
13. Vendosjeje pa kompensim në shtëpitë e personave të moshuar.
14. Lirimi nga shpenzimet e administratës në shkollimin universitar.

- 6.2. Këto të drejta i realizojnë edhe të gjitha familjet e dëshmorëve të kombit të rënë në forma të ndryshme në të gjitha periudhat e luftës për liri.
- 6.3. Bashkëshorti/ja që lidh martesë të re i humb të drejtat e parapara me këtë Ligj të cilat i ka shfrytëzuar si anëtar i familjes së dëshmorit.
- 6.4. Kur fëmijët e dëshmorit pa përkujdesje prindërore janë përfitues të pensionit familjar, këtë të drejtë e realizojnë deri në moshën 18 vjeçare, përkatësisht deri në moshën 26 vjeçare nëse janë në shkollim të rregullt.
- 6.5. Anëtarët e familjes së veteranit dhe pjesëtarit të UÇK-së të marrur peng apo të zhdukur, i realizojnë të gjitha të drejtat, të cilat në këtë Ligj janë të parapara për anëtarët e familjes së dëshmorit të UÇK-së,
- 6.6. Baza e pensionit familjar për familjen e dëshmorit është 180 % nga paga minimale e realizuar në Kosovë.
- 6.7. Baza e pensionit familjar për familjen e cila i ka dhënë për lirinë e Kosovës 2 dëshmorë, rritet për 20 %.
- 6.8. Baza e pensionit familjar për familjen e cila i ka dhënë për lirinë e Kosovës 3 dëshmorë, rritet për 30 %.
- 6.9. Baza e pensionit familjar për familjen e cila i ka dhënë për lirinë e Kosovës 4 dëshmorë, rritet për 40 %.
- 6.10. Baza e pensionit familjar për familjen e cila i ka dhënë për lirinë e Kosovës më shumë se 4 dëshmorë, rritet për 50 %.
- 6.11. Përfituesve të cilëve iu është njohur e drejta në pension familjar sipas këtij Ligji, u hiqet e drejta e përfitimit të familjes nga Skema e Ndhmës Sociale.

Neni 7

Të drejtat e invalidëve të UÇK-së

Invalidët e UÇK-së sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në këtë Ligj realizojnë këto të drejta:

1. Pensionin invalidor personal,
2. Shtesa për përkujdesje dhe ndihmë personit tjetër,
3. Kompensimin ortopedik,
4. Përkujdesjen shëndetësore primare, sekondare dhe terciare pa kompensim në institucionet shëndetësore publike,
5. Rehabilitim shëndetësor dhe fizikal,
6. Riaftësim profesional,
7. Përparësi në punësim në kushte të barabarta,
8. Lehtësime tatimore dhe doganore,
9. Përparësi për regjistrim në institucione arsimore,
10. Bursë për shkollim,
11. Vendosje në konvikte pa kompensim,
12. Tekste shkollore falas për arsimin fillor dhe të mesëm për fëmijët e invalidit,
13. Përkujdesje në banim,
14. Lirim nga taksa gjyqësore, administrative dhe publike,

15. Tarifë të lirë dhe të reduktuar të konsumit të energjisë elektrike,
16. Lirim nga tatimi në pronë të paluajtshme,
17. Vendosjeje në shtëpitë e personave të moshuar pa kompensim,
18. Përshtatjen e ambientit për lëvizje të mjeteve ortopedike pa pengesa në hyrje të shtëpisë - banesës,
19. Shpenzimet e varrimit krahas ofrimit të nderimeve ushtarake.

Neni 8

Invalidët e UÇK-së sipas shkallës së invaliditetit

8.1. Me qëllim të realizimit të të drejtave të përcaktuara më këtë Ligj, sipas shkallës së invaliditetit, invalidët e UÇK-së radhiten në tetë (8) grupe, sipas përqindjes së përcaktuar të dëmtimit trupor:

1. Grupi I - invalidët me mbi 80% të dëmtimit trupor, të cilëve për jetë të rregullt u nevojitet përkujdesja dhe ndihma e personit tjetër.
2. Grupi II - invalidët me 71% deri 80% të dëmtimit trupor,
3. Grupi III - invalidët me 61% deri 70% të dëmtimit trupor,
4. Grupi IV - invalidët me 51% deri 60% të dëmtimit trupor,
5. Grupi V - invalidët me 41% deri 50% të dëmtimit trupor,
6. Grupi VI - invalidët me 31% deri 40% të dëmtimit trupor,
7. Grupi VII - invalidët me 21% deri 30% të dëmtimit trupor,
8. Grupi VIII - invalidët me 10 deri 20% të dëmtimit trupor.

8.2. Vlerësimin për shkallën e invaliditetit sipas paragrafit 1 të këtij neni, e jep Komisioni Mjekësor i shkallës së parë dhe shkallës së dytë i Departamentit të Familjeve të Dëshmoreve, Invalidëve të Luftës, dhe Viktimave Civile pranë MPMS-së.

8.3. Baza e pensionit invalidor personal është 140 % e pagës minimale të realizuar në Kosovë, në vitin paraprak.

8.4. Invalidi i UÇK-së me dëmtim trupor, përkatësisht me shkallë të invaliditetit mbi 80 % e realizon pensionin invalidor personal në lartësi 100 % nga baza e pensionit.

8.5. Invalidi i UÇK-së me dëmtim trupor, përkatësisht me shkallë të invaliditetit prej 71 % - 80 % e realizon pensionin invalidor personal në lartësi 80 % nga baza e pensionit.

8.6. Invalidi i UÇK-së me dëmtim trupor, përkatësisht me shkallë të invaliditetit prej 61 % - 70 % e realizon pensionin invalidor personal në lartësi 70 % nga baza e pensionit.

8.7. Invalidi i UÇK-së me dëmtim trupor, përkatësisht me shkallë të invaliditetit prej 51 % - 60 % e realizon pensionin invalidor personal në lartësi 60 % nga baza e pensionit.

8.8. Invalidi i UÇK-së me dëmtim trupor përkatësisht me shkallë të invaliditetit prej 41 % - 50 % e realizon pensionin invalidor personal në lartësi 50 % nga baza e pensionit.

8.9. Invalidi i UÇK-së me dëmtim trupor përkatësisht me shkallë të invaliditetit prej 31 % - 40 % e realizon pensionin invalidor personal në lartësi 40 % nga baza e pensionit.

8.10. Invalidi i UÇK-së me dëmtim trupor përkatësisht me shkallë të invaliditetit prej 20 % - 30 % e realizon pensionin invalidor personal në lartësi 30 % nga baza e pensionit.

8.11. Invalidi i UÇK-së prej 10 deri 19 % nuk e gëzon pensionin invalidor personal.

8.12. Invalidi i UÇK-së me dëmtim trupor përkatësisht me shkallë të invaliditetit mbi 80 % ka të drejtë në shtesë për ndihmë dhe kujdes nga personi tjetër, në lartësi prej 30 % të bazës së pensionit invalidor personal.

8.13. Nëse familja e shfrytëzuesit të pensionit invalidor personal është edhe shfrytëzuese e pensionit familjar, atëherë shfrytëzimi i të drejtës së parë nuk e përjashton mundësinë e shfrytëzimit të së drejtës tjetër.

8.14. Përfituesi, të cilit i është njohur e drejta e pensionit invalidor, nuk e përjashton të drejtën e anëtarëve të tjerë të familjes për përfitim nga Skema e Ndihmës Sociale.

Neni 9

Të drejtat në pensionin invalidor familjar pas vdekjes së invalidit të UÇK-së

9.1. Pas vdekjes së invalidit të UÇK-së, të drejtën në pensionin invalidor familjar e realizojnë anëtarët e familjes së tij të ngushtë.

9.2. Baza e pensionit invalidor familjar pas vdekjes së invalidit të UÇK-së është 80 % nga shuma mujore e pensionit invalidor të paguar në muajin e fundit.

9.3. Bashkëshorti/ja që lidh martesë të re i humb të drejtat e parapara me këtë Ligj, të drejta të cilat i ka shfrytëzuar si anëtar i familjes së invalidit të UÇK-së.

9.4. Kur fëmijët e invalidit të UÇK-së pa përkujdesje prindërore janë përfitues të pensionit familjar, këtë të drejtë e realizojnë deri në moshën 18 vjeçare, përkatësisht deri në moshën 26 vjeçare nëse janë në shkollim të rregullt.

9.5. Të drejtat e tjera nga pensioni invalidor personal nuk barten në pensionin invalidor familjar.

Neni 10

Të drejtat e veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së

10.1. Veteranët dhe pjesëtarët e UÇK-së sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në këtë Ligj realizojnë këto të drejta:

1. Stazh të dyfishtë, për kohën e kaluar në luftë,
2. Përkujdesje shëndetësore primare pa kompensim në institucionet publike shëndetësore,
3. Përparësi në punësim me kushte të barabarta,
4. Përparësi regjistrimi në institucionet arsimore,
5. Përparësi në bursë për shkollim,
6. Lirimi nga tatimi në pronë, për ata të cilët janë në gjendje të rëndë materiale.
7. Përparësi vendosjeje në konvikte,
8. Shpenzimet e varrimit krahas ofrimit të nderimeve ushtarake.

10.2. Të drejtat e përcaktuara nga pika 2 deri në pikën 5 të këtij neni i realizojnë edhe anëtarët e familjeve të veteranëve të UÇK-së.

10.3. Veteranët e UÇK-së për kontributin dhe sakrificën në luftën e UÇK-së kundër forcave të okupatorit gëzojnë imunitet konform ligjeve të vendit tonë dhe konventave ndërkombëtare.

10.4. Personat të cilët kanë qenë të organizuar si veteranë të UÇK-së, të cilët para datës 20 qershor 1999, kanë lëshuar radhët e UÇK-së, pa urdhër të Komandës Kompetente të UÇK-së, nuk mund të realizojnë asnjë të drejtë apo të kenë të kenë status sipas dispozitave të këtij Ligji.

Neni 11

Të drejtat e anëtarëve të familjes së viktimës civile të luftës

11.1. Anëtarët e familjes së viktimës civile të luftës, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në këtë Ligj realizojnë këto të drejta:

1. Pensionin familjar civil të luftës,
2. Përkujdesjen shëndetësore primare pa kompensim në institucionet shëndetësore publike,
3. Lirim nga tatimi në pronë, nëse familja është në gjendje të rëndë materiale,
4. Tarifën e lirë dhe të reduktuar të konsumit të energjisë elektrike, nëse familja është në gjendje të rëndë materiale,

11.2. Shfrytëzues të pensionit sipas radhës janë: bashkëshorti/ja, fëmijët, fëmijët jashtëmartesor, fëmijët e adoptuar (birësuar), thjeshtri, thjeshtra, prindërit (babai, nëna, njerku, njerka).

11.3. Bashkëshorti/ja që lidhë martesë të re i humb të drejtat e parapara me këtë Ligj, të cilat i ka shfrytëzuar si anëtar i familjes së viktimës civile të luftës.

11.4. Kur fëmijët e viktimës civile të luftës pa përkujdesje prindërore janë përfitues të pensionit familjar këtë të drejtë e realizojnë deri në moshën 18 vjeçare përkatësisht deri në moshën 26 vjeçare nëse janë në shkollim të rregullt.

11.5. Baza e pensionit familjar të viktimës civile të luftës është 100 % nga paga minimale në Kosovë.

11.6. Anëtarët e familjes së viktimës civile të luftës, të marrur peng apo të zhdukur në periudhën e luftës, prej 27.02.1998 deri më 20.06.1999 i realizojnë të gjitha të drejtat, të cilat në këtë Ligj janë përcaktuar për anëtarët e familjes së viktimës civile të luftës.

Neni 12

Të drejtat e invalidit civil të luftës

12.1. Të drejtën në pensionin invalidor civil të luftës e realizon invalidi civil i luftës në bazë të dëmtimit trupor, përkatësisht shkallës së invaliditetit prej 40 % deri 100 %.

12.2. Baza e pensionit invalidor civil të luftës është 100 % e pagës minimale në Kosovë.

12.3. Invalidit civil të luftës me dëmtim trupor, përkatësisht me shkallë të invaliditetit mbi 80 % i takon pensioni invalidor personal në lartësi 90 % nga baza e pensionit.

12.4. Invalidit civil të luftës me dëmtim trupor, përkatësisht me shkallë të invaliditetit prej 61% - 80% i takon pensioni invalidor personal në lartësi 80% nga baza e pensionit”.

12.5. Invalidit civil të luftës me dëmtim trupor, përkatësisht me shkallë të invaliditetit prej 40 % - 60 % i takon pensioni invalidor personal në lartësi 70 % nga baza e pensionit.

12.6. Invalidi civil i luftës me dëmtim trupor mbi 40% realizon pa pagesë shërbimet shëndetësore në qendrat shëndetësore publike në Kosovë.

12.7. Invalidi civil i luftës me dëmtim trupor mbi 80% lirohet nga tatimi dhe doganat për importimin e mjeteve të adoptuara lidhur me paaftësitë e tij.

12.8. Invalidi civil i luftës me dëmtime trupore, përkatësisht me shkallë të invaliditetit mbi 80% ka të drejtë në shtesë për ndihmë dhe kujdes nga personi tjetër, në lartësi prej 30% të bazës së pensionit invalidor personal.

Neni 13

Të drejtat në pensionin invalidor familjar pas vdekjes së invalidit civil

13.1. Të drejtën në pensionin invalidor familjar pas vdekjes së invalidit civil e realizojnë anëtarët e familjes së tij të ngushtë.

13.2. Baza e pensionit invalidor familjar është 80 % nga shuma mujore e pensionit invalidor të paguar në muajin e fundit.

13.3. Bashkëshorti/ja që lidh martesë të re i humb të drejtat e parapara me këtë Ligj, të cilat i ka shfrytëzuar si anëtar i familjes së invalidit civil.

13.4. Kur fëmijët e invalidit civil pa përkujdesje prindërore janë përfitues të pensionit familjar këtë të drejtë e realizojnë deri në moshën 18 vjeçare përkatësisht deri në moshën 26 vjeçare nëse janë në shkollim të rregullt.

13.5. Të drejtat e tjera nga pensioni invalidor personal nuk barten në pensionin invalidor familjar

KREU IV DISPOZITAT E POSAÇME

Neni 14

Aktet nënligjore për zbatimin e ligjit

Për zbatimin e drejt dhe efikas të këtij ligji në afat prej 6 muajsh nga data e hyrjes në fuqi nxirren këto akte nënligjore:

(1) Nga Ministria e Punës dhe Mirëqenie Sociale:

1. Për punën e Komisionit mjekësor në procedurën për caktimin e shkallës së dëmtimit trupor të organizmit të invalidit nga nenet 8 dhe 12 të këtij ligji,
2. Për kushtet dhe kriteret e aftësisimit profesional të invalidit nga neni 5 i këtij ligji,
3. Për shumën e shpenzimeve të transportit dhe të varrimit nga neni 5 i këtij ligji,
4. Për mënyrën e pagesës së të ardhurave dhe të shpenzimeve të tjera sipas këtij ligji,
5. Për mënyrën e mbajtjes së evidencës mbi pagesat e bëra sipas këtij ligji dhe kontrollin e shpenzimit destinues të parave,
6. Për mënyrën dhe procedurën e përcaktimit të stazhit të dyfishtë nga neni 5 i këtij ligji.

(2) Nga Ministria e Shëndetësisë:

1. Për shfrytëzimin e të drejtës për rehabilitim shëndetësor, përkatësisht fizikal, nga neni 5 i këtij ligji,
2. Për realizimin e shërbimeve shëndetësore në institucionet shëndetësore publike nga neni 5 i këtij ligji,
3. Për mjetet ndihmëse ortopedike dhe mjetet e tjera, nga neni 5 i këtij ligji.

(3) Nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë:

1. Për mënyrën dhe procedurën e ndarjes së teksteve shkollore falas nga neni 5 i këtij ligji,
2. Për kushtet dhe kriteret e realizimit të të drejtës së bursës nga neni 5 i këtij ligji.

(4) Nga Ministria e Energjetikës dhe e Minierave:

1. Për procedurën dhe mënyrën e shfrytëzimit të energjisë elektrike të lirë dhe të reduktuar, nga neni 5 i këtij ligji.

(5) Nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor:

1. Për procedurën dhe mënyrën e përshtatjes së qasjes në ndërtesë nga neni 5 i këtij ligji.

(6) Nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave:

1. Për procedurën e realizimit të lehtësirave doganore dhe tatimore nga neni 5 i këtij ligji.

(7) MPMS-ja në bashkëpunim me Ministrinë e tjera të Qeverisë së Kosovës nxjerr edhe akte të tjera nënligjore për implementimin e këtij Ligji.

KREU V NJOHJA E STATUSIT

Neni 15

Organet kompetente për njohjen e statusit

15.1. Statusi i dëshmorit të kombit, invalidit, veteranit, dhe pjesëtarit të zhdukur apo të internuar të UÇK-së, konstatohet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidët e Luftës dhe Viktimat Civile) në mbështetje të dokumentacionit që e lëshon SHP i TMK-së dhe në bashkëpunim sipas nevojës me shoqatat e dalura nga lufta, në përputhje me aktet nënligjore të këtij Ligji.

15.2. Statusi i viktimës civile dhe invalidit civil të luftës, konstatohet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidët e Luftës dhe Viktimat Civile) në mbështetje të dokumentacionit që e lëshon organi kompetent i komunës në përputhje me procedurat administrative, në bazë të kërkesës së anëtarit të familjes.

15.3. Statusi i dëshmorit të kombit i rënë për lirinë e Kosovës konstatohet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidët e Luftës dhe Viktimat Civile) në mbështetje të dokumentacionit që e lëshon organi kompetent i komunës në përputhje me procedurat administrative, në bazë të kërkesës së anëtarit të familjes.

KREU VI
PROCEDURAT PËR REALIZIMIN E TË DREJTAVE

Neni 16
Vendimet dhe ankesat

16.1. Të drejtat e përcaktuara me këtë Ligj i realizojnë qytetarët e Kosovës dhe shtetasit e huaj të cilët e kanë fituar statusin e kategorive përkatëse të përcaktuara me këtë Ligj.

16.2. Parashtruesi i kërkesës për realizimin e të drejtave nga ky Ligj, duhet ta paraqesë kërkesën në zyrën të Departamentit për Familjet e Dëshmorëve, Invalidët e Luftës dhe Viktimat Civile.

16.3. Njohjen e statusit dhe vendimin për realizimin e të drejtave, e nxjerr Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidët e Luftës dhe Viktimat Civile i MPMS-së.

16.4. Parashtruesi i kërkesës në afat prej 15 ditësh mund t'i paraqesë ankesë Komisionit për Ankesa në shkallën e dytë, kundër vendimit të nxjerrë në shkallën e parë.

16.5. Parashtruesi i kërkesës kundër vendimit të organit të shkallës së dytë mund të fillojë kontestin administrativ në Gjykatën Supreme të Kosovës në afat prej 30 ditësh.

16.6. Pensioni familjar, pensioni personal invalidor, pensioni familjar invalidor, si dhe shtesat për përkujdesje dhe ndihmë personit tjetër, realizohet nga dita e parë e muajit që pason, nga dita e paraqitjes së kërkesës, nëse janë plotësuar kushtet për realizimin e të drejtës. Dita e plotësimit të kushteve për realizimin e të drejtës nga kjo pikë konsiderohet dita kur vendimi mbi këtë të drejtë merr formën përfundimtare.

16.7. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, përkatësisht Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidët e Luftës dhe Viktimat Civile, për rregullimin dhe avancimin e procedurave, në përputhje me nenin 14 paragrafi 6 të këtij Ligji, mund të hartojë dhe nxjerrë akte të tjera nënligjore.

KREU VII
DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 17

17.1. Me gjobë në të holla prej 1.500 € deri 3.000 € do të gjobiten për kundërvajtje nëse nuk i zbatojnë dispozitat e këtij Ligji:

1. Organi kompetent për zbatimin e këtij Ligji dhe,
2. Personat e tjerë juridik të involvuar që nuk i përmbahen dispozitave të këtij Ligji.

17.2. Për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni, gjobitet me të holla prej 300 € deri 1.000 € personi përgjegjës i organit kompetent dhe eprori i këtij organi.

17.3. Çdo person i cili me vetëdije, për realizimin e të drejtave nga ky Ligj, paraqet deklaratë të rreme apo prezanton dokumente të falsifikuara me qëllim të përfitimit të skemave pensionale nga ky Ligj, do të gjobitet prej 200 € deri në 500 €

KREU VIII
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE

Neni 18

18.1. Kërkesat dhe procedurat për realizimin e të drejtave të përcaktuara në këtë Ligj të cilat janë në shqyrtim e sipër, pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji do të rregullohen dhe përcaktohen sipas dispozitave të këtij Ligji.

18.2. Me ligje të veçanta do të rregullohen :

1. Njohja e Statusit të veçantë Komandant Legjendar i UÇK-së për ADEM JASHARIN.
2. Statusi për të Burgosurit Politik,
3. Statusi për Veteranët e Rezistencës,
4. Njohja e Statusit të Veçantë të FAMILJES JASHARI,
5. Përcaktimi i Lokacioneve për Përmendore Lapidare dhe Varreza të Dëshmorëve në Periudhën e Luftës së UÇK-së,
6. Dekoratat dhe Mirënjohjet për Dëshmorët dhe Luftëtarët e UÇK-së,
7. Dekoratat dhe Mirënjohjet për Dëshmorët dhe Luftëtarët e Lirisë së Kosovës.
8. Shpallja e heronjve të popullit.
9. Statusi i ish të internuarve gjatë luftës.

Neni 19

Zbatimi i Ligjit

19.1. Aktet dhe dispozitat e nxjerra nga organet kompetente të ish-UÇK-së dhe TMK-së janë valide për zbatimin e këtij Ligji.

19.2. Shfrytëzuesit e pensionit bazë, mund të realizojnë të gjitha të drejtat dhe benificionet e përcaktuara me këtë Ligj, nëse i përmbushin kushtet dhe kriteret sipas dispozitave të këtij Ligji.

19.3. Përfituesit nga Ligji për Pensionet e personave me aftësi të kufizuara, nuk mund të jenë shfrytëzues të të drejtave nga ky Ligj.

19.4. Të drejtat e përcaktuara sipas këtij Ligji nuk vjetërsohen.

19.5. Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji, pushon së vepruari Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/66 e datës 21.12.2000 dhe çdo dispozitë ligjore që është në kundërshtim me këtë Ligj.

Neni 20

Hyrja në fuqi

Ky Ligj hyn në fuqi pas miratimit në Kuvendin e Kosovës dhe shpalljes nga ana e Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Ligji Nr. 02/L-2
23 shkurt 2006

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

akademik Nexhat Daci